



## P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) - Rahovec, e mbajtur më **14.5.2024**, me fillim në orën **15:00**. Mbledhjen e kryesoit Kryetari i Komunës, **Smajl Latifi**. Për mbajtjen e mbledhjes, kuorumi ekziston. **Kryetari:** Më lejoni t'i përshëndes anëtarët e KKSBB-së, drejtorët e drejtorive, komandantin e Stacionit të Policisë në Rahovec, Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e FSK-së, të shoqërisë civile, të bizneseve, të komuniteteve pakicë, të OSBE-së, të KFOR-it, të UEN-it, të LMT-së, zyrtarët komunalë dhe mediet. Është mbledhja e **tretë** e rregullt për vitin 2024. Siç e dini, ndërmjet dy mbledhjeve, kemi mbajtur një mbledhje urgjente të KKSBB-së. Për këtë mbledhje të rregullt, propozoj këtë rend dite:

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,**
  - **Siguria në trafik;**
  - **Identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike,**
  - **Prishja e rendit dhe e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm.**
  - **Vendosja dhe funksionalizimi i kamerave shtesë të sigurisë në hapësirat publike në rrugët kryesore;**
- 3. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror;**
- 4. Trajtimi i objekteve të braktisura dhe i objekteve të vjetra, jo të sigurta;**
- 5. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat;**
- 6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;**
- 7. Të ndryshme.**

**Kryetari** – Mirëdita, të nderuar pjesëmarrës! Është mbledhja e tretë e Këshillit Komunal për Sigurinë në Bashkësi. Përshendetje për përfaqësues të KFOR-it, të OSBE-së, përshendetje për të gjithë! Rendin e ditës e keni para vetes.

A ka dikush ndonjë koment rrëth këtij propozimi për rend dite?... Nëse jo, po e vendosi në votim, kush është “për” miratimin e pikave të cilat i paraqita? A ka votë kundër?... abstenime?... Konstatojmë që miratohet rendi i ditës për këtë mbledhje.

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

A ka dikush ndonjë vërejtje, koment ose plotësim rrëth procesverbalit?...

Nëse nuk ka, atëherë po e vendosi në votim. Kush është “për”?... a ka votë kundër?.. abstenime?... Konstatojmë që me 1 abstenim dhe të tjerat “pro”, aprovohet pika e parë. Kalojmë në pikën e dytë.

**2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit:**

Siç e dini, si pjesë përbërëse e kësaj pike janë edhe nënpikat që janë pjesë e këtij rendi të ditës.

Çështjet ose temat, të cilat mund t'i trajtojmë në kuadër të kësaj pike, janë: Siguria në trafik, identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike, prishja e rendit dhe e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm, vendosja dhe funksionalizimi i kamerave shtesë të sigurisë në hapësirat publike, në rrugët kryesore.

Ne, në takimin e kaluar, mendoj që kemi pasur situata më shqetësuese, më sfiduese, për shkak të vjedhjeve, pra, plaçkitjeve që kanë qenë aktuale dhe ka pasur më shumë aktivitete të policisë. Përkundër kësaj,

besojmë që ka stabilitet, qëndrueshmëri, edhe gjendja e përgjithshme e sigurisë në Komunën e Rahovecit është e qetë dhe stable. Aktualisht jemi në procesin e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave dhe besoj që, pavarësisht përfundimin e rezultatit, besoj që qytetarët po regjistrohen pa dallim dhe ky është lajm i mirë për komunën tonë. Po regjistrohen të gjithë, pavarësisht përkatësisë etnike. Regjistrimi i popullsisë, sipas informatave që i kam nga regjistruesit dhe mbikëqyrësit e regjistruesve, kemi reshitim të popullsisë kudo, në qytet dhe në secilin fshat.

Nuk dua ta zgjas më shumë, po e kaloj fjalën te komandanti, ndoshta ka diçka për të thënë dhe njëkohësisht mund të hapet debati dhe të jetë përbajtjesor.

**Fazli Morina:** Faleminderit, kryetar! Të nderuar pjesëmarrës në sallë, përshëndetje për të gjithë! Ashtu siç e tha edhe kryetari, situata e sigurisë në zonën tonë të përgjegjësisë konsiderohet dhe vlerësohet që është e qetë dhe stable. Pavarësisht rasteve të cilat kanë ndodhur, sepse është shumë normale, si në çdo vend tjetër të botës. Jemi në vazhdimësi dhe po vazhdohet në implementim të shumë planeve operative dhe urdhëresave të tjera. Gjithsej janë 40 urdhëresa, 7 plane operative, 10 plane të veprimit dhe 2 projekte, njëri prej tyre është "Iniciativat për shkolla të sigurta". Në stacionin në Rahovec, janë regjistruar gjithsej 60 raste vepra penale, 7 incidente jopenale. Vjedhje - 4 raste, armëmbajtje pa leje - 3 raste, lëndim i lehtë trupor - 11 raste, kanosje - 6 raste, sulm - 4 raste, dhunë në familje - 12 raste. Gjatë trajtimit të të gjitha këtyre rasteve, 32 persona janë arrestuar, ndërsa prej tyre 17 janë ndalur dhe kanë kaluar në mbajtje për 48 orë. Sa i përket ekipit për ndërlidhjen me gjykatat dhe njësitë e tjera, janë analizuar 31 urdhëresa të gjykatës, 22 asistime të institucioneve dhe të drejtoreve të ndryshme, ndërsa pjesa e sigurisë në komunikacion rrugor është vazhdimësi e projekteve që janë në fuqi akoma. Gjatë kësaj kohe, të shqiptuara janë 1261 gjoba në komunikacion rrugor, 52 gjoba janë për drejtim të automjetit pa patent-shofer, 9 gjoba për masë të ndalimit, 120 gjoba për parkingje joadekuate, 18 gjoba për përdorim të telefonit gjatë drejtimit të automjetit dhe 4 gjoba për prishje të qetësisë publike. Aksidentet trafiku, gjithsej 14 raste, 8 prej tyre janë me lëndime trupore dhe që janë trajtuar nga njësia e komunikacionit rrugor në Gjakovë. Zyra e Asistimit Informativ pas stacionit tonë, gjatë kësaj kohe ka lëshuar 500 kërkesa për të kaluar kriminale dhe 240 kërkesa për dokumente të humbura. Më 17 mars, nga ora 18:00, dy qytetarë të komunitetit serb kanë festuar festën tradicionale ortodokse "Proçka". Siguria në shkolla është në gjendje shumë më të mirë se në takimet e tjera dhe përfatë mirë nuk kemi asnjë rast të raportuar gjatë kësaj periudhe. Ligjëratat kanë vazhduar në dy shkolla fillore me temat: bullizmi dhe masat parandaluese. Aktualisht, jemi duke vazhduar në pilot-projektin për njerëzit e iniciativave në shkolla të sigurta. Patrullimet dhe pikat të kontrollit në afërsi të shkollave gjatë periudhës raportuese janë realizuar 54 kontakte në shkolla, 408 patrullime dhe 35 pika të kontrollit në afërsi të shkollave. Ditëve të fundit kanë qenë edhe 3 plane të tjera operative, 1 është me tubimin me karakter fetar, dita e "Shën Gjergjit" në fshatin Pataqan, tjetra në fshatin Dejnë dhe së fundi, nata e fundit, pjesë e festivalit folklorik "Anadrinia jehon". Në realitet ka qenë angazhim mjaft i madh po përfatë mirë, kur i kthehemë në situatën e sigurisë, vlerësohet mirë dhe është shumë e qetë. Kisha apeluar që të gjithë anëtarët që janë këtu të përdorin ndikimin e vet te të tjerët. Sinqerisht është shumë e rëndë, shumë fjalë fyeze, shumë ofenduese, së fundi janë drejtuar në drejtim të policisë. Ata do të dalin para drejtësisë dhe do të përgjigjen për të gjitha lajmet dhe postimet që i kanë postuar apo edhe thënë.

**Kryetari :** Faleminderit, komandant! E hapim debatin për pikën e dytë të rendit të ditës, në qoftë se dikush dëshiron ta marrë fjalën, le të urdhërojë.

Si konkluzion, gjendja vazhdon të mbetet stable, përkundër faktit që ka sfida, angazhime, përkushtime të secilit institucion, por edhe të komuniteteve, me qëllim që të ruhet edhe më tutje gjendja e sigurisë së përgjithshme. Pra, të ketë qëndrueshmëri dhe stabilitet, sepse për këto kemi nevojë më së shumti. Faleminderit komandant, kalojmë në pikën e tretë:

### **3. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtjen nga zjarri gjatë sezonit veror:**

**Besmire Bytyqi:** Faleminderit, kryetar! Të nderuar anëtarë të KKSBB-së, ne si drejtori jemi duke i ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për vetëdijesimin e qytetarëve për të mos ndezur zjarre dhe për të lajmëruar zjarret dhe zjarrvënësit në kohë sa më të shpejtë. Tani kemi filluar me ligjërata në shkollat e mesme, të cilat do t'i vazhdojmë edhe me takime individuale, si dhe me thirrje në rrjete sociale. Duke përcuar mesazhin për mosndezje të zjarreve, numrat e zjarrfikësve, 112 numri unik emergjent. Policia e Kosovës dhe njësitë zjarrfikës dhe shpëtimit, numra të cilët duhet të na kontaktoni dhe të bashkëpunoni me ne për të lajmëruar zjarret në kohë sa më të shpejtë. Faleminderit!

**Kryetari:** Faleminderit, Besë! Unë besoj që njësia jonë e zjarrfikësve ka pajisje, ka edhe përvojë. Besoj që edhe komunikimi ndërmjet njësisë sonë dhe qendrës rajonale është i mirë dhe shpresojmë që fushata për edukimin, vetëdijesimin përrrezik nga zjarri dhe mbrojtja nga zjarri, do të vazhdojë dhe do të janë temë aktuale, jo vetëm nga njësia e zjarrfikësve, po edhe nga të gjithë ne.

### **4. Trajtimi i objekteve të braktisura dhe i objekteve të vjetra, jo të sigurta:**

Në Sheshin e Republikës ose në rrugët që çojnë atje, janë disa objekte të vjetra, të braktisura, që dikush nuk është ndoshta gjallë, dikush po. Është pamje e cila nuk e nderon asnjërin prej nesh, asnjë qytetar. Unë kam kërkuar që Gjeodezia, bashkë me Inspektoratin, Shërbimet Publike, më së paku të tentojmë përpjekje që pronat private të braktisura, që paraqesin rrezik të përgjithshëm për qytetarët, të mbrohet ose të rrënohet, sepse ato mund të shndërrrohen edhe në vratat ku kultivohen, ose ku shfaqen fenomene negative. Menjëherë duhet të marrim hapa konkrete në këtë drejtim. Është keq ajo pjesë e vjetër e qytetit dhe ka nevojë për pastrim dhe mirëmbajtje.

Kemi edhe diku në qendër dhe që janë objekte private. Më lehtë e kemi kur janë pronë publike, por edhe aty ka sfida, sepse duhet të merremi vesh edhe me plot operatorë të tjera, besa edhe me pretendues që kanë pretendime përrzonë, përrrezik nga ato objekte të vazhdojnë të kultivojnë diçka që paraqet rrezik përsigurinë e qytetarëve. Nëse kthehen në muze është në rregull, por nëse mbesin veç ashtu siç janë, atëherë është rrezik.

### **5. Mbrotja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinë:**

**Kryetari:** Ne kemi më pak mbeturina sot, sesa që kemi pasur dje dhe jemi duke punuar që nesër të kemi edhe më pak sesa që kemi sot. Megjithatë, mbeturina kemi. Është mirë që jemi duke i eliminuar deponitë ilegale, inerte dhe të amvisërisë, por përsëri ka tendencia të njerëzve të pakujdeshëm që vazhdojnë e ndotin ambientin me hedhje të gjësendeve. Kemi shumë aktivitete dhe fushata kundër ndotjes së ambientit, së paku në ato vende ku mund të dëmtohet kualiteti i ujit, i përrrenjve. E kemi në fokus dhe prioritet të përbashkët që sa më shumë t'i mbrojmë lumenjtë, brigjet e lumenjve, varrezat, vendet publike. Duhet të kemi maturi, sikurse në oborret tona që nuk kemi mbeturina, njëjtë është edhe në pronën publike, sepse tani dalin shumë telashe.

Jo vetëm që detyroheni t'i pastroni dhe njëkohësisht të gjobiteni, por ndikon keq edhe në imazh. Ne si komunë përfitojmë grante. Jemi komunë që, sidomos në qytet brenda, janë disa deponi që ende nuk po mund t'i shkatërrojmë, sepse janë të kahershme, mbi 25 vjet. Ekoregionit i kam kërkuar që t'i eliminojë. Ka të tillë edhe afér lumit Duhllo dhe nëpër disa rrugica. Në Drinin e Bardhë i kemi vendosur dy "prita" dhe jemi duke e bërë matjen se sa kanë ndikim në mbledhjen e mbeturinave këto dy "prita". Është një projekt ndërkufitar që e kemi fituar me Bashkinë e Kukësit. E vërejmë efektin zakonisht kur ka reshje të shiut.

### **6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore:**

**Nora Boshnjaku:** Faleminderit, kryetar! Përshëndetje për anëtarët e KKSBB-së! Sa i përket pikës së sigurisë dhe kontrollit të produkteve ushqimore, ne në vazhdimësi kemi pranuar ankesa nga departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve. Inspektorët e tregut i kanë marrë të gjitha masat e nevojshme, duke i bërë kontrolllet rutinore nëpër supermarketet dhe nëpër furra të bukës që veprojnë në territorin e Komunës së Rahovecit. Sigurisht që kjo temë është sfidë në vete, mirëpo, në bashkëpunim me inspektoratin sanitari, po tentojmë që ta kemi një aksion të përbashkët për asgjësimin e të gjitha produkteve që janë me afat të skaduar dhe njëkohësisht përbëjnë rrezik për mirëqenien e qytetarëve. Së fundmi, nga vetë supermarketet e qytetit, kemi pasur kërkesa për asgjësim të mallrave dhe inspektorët e tregut dhe ata sanitari kanë dalë në terren dhe janë përgjigjur në bazë të kompetencave që i kanë. Ju lus, nëse keni ndonjë shqetësim që lidhet me sigurinë dhe kontrollin e produkteve ushqimore, na informoni dhe siguroj që do t'i ndërmarrim të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

#### 7. Të ndryshme:

**Egzon Hamza:** Përshëndetje për të gjithë! Inderuari kryetar, desha t'ju informoj që kërkesa e cila ishte parashtruar në lidhje me vendosjen e pengesave në rrugë, ka filluar të realizohet. Për këtë dëshiroj t'ju shpreh mirënjojje dhe falënderime juve në veçanti dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa! Dua të ndërlidhem diçka rrëth ndriçimit publik. Më datë 2 shkurt, e kam dorëzuar një kërkesë. Para festës së Fitër Bajramit, së bashku me kompaninë përgjegjëse, ishim në vend të ngjarjes, ku shikuam nga afër terrenin dhe mundësinë e vendosjes së 9 poçeve. Që nga ajo kohë, për këtë çështje nuk kam marrë asnjë informatë. Jemi në kontakt me drejtor Përparimin, por ende nuk e dimë një datë se kur banorët e asaj lagjeje multietnike ta gëzojnë ndriçimin. Kërkoj nga ju që të na caktoni një datë, apo përafërsisht kur do të realizohet ndriçimi?

**Sabahudin Durguti:** Përshëndetje, kryetar! E kam një shqetësim në rrugën “Gani Mullabazi”, ne jemi duke vuajtur për ujë aty. Është një bazen aty afër, por shtypja është shumë e vogël. Një kojshi aty e ka ngritur shtëpinë edhe një kat dhe besoni që në katin e dytë mezi pikon uji. Ne jemi të lidhur me një bazen më lart. Nuk e di pse na shkyçin prej atij bazeni dhe na kyçin në tjetrit. Punëtorët e ujësjellësit thonë që gypi i lagjes është i ngushtë, por kjo nuk është e vërtetë, sepse deri para 2-3 muajve unë e kam në “sahat” e kam ndalë shtypjen, sepse ka qenë shumë e madhe. Sa i përket ndriçimit publik, e falënderoj Përparimin shumë, sepse aty na ka bërë me drita të mira!

**Kryetari:** Faleminderit, bac! Dikush lypi data. Nuk guxojmë të flasim me data, sepse ka raste kur njerëzit ndriçimin po e dëmtojnë me ose pa vetëdije. Më duket se na duhet më shumë punë edukative, sidomos me këtë gjeneratën më të re. Kompania ka punuar në qytet në mirëmbajtje të ndriçimit. Ka pasur disa rrugë në të cilat ndriçimi nuk ka pasur kabllo. Egzon, rri në kontakt me Përparimin. Sa i përket ujit të pijshëm: e kam një përshtypje që jemi duke e përjetuar një menaxhim të dobët të resursit jetik – ujin e pijshëm. Aty, ujë ka shumë, gypa ka shumë, ndërsa këtu ujë nuk ka. Po e them menaxhim të dobët, sepse zyrtarët kanë probleme dhe inate të ndërsjella. Jemi takuar dhe jam treguar i ashper me ta. Me Ismet Ahmetin jemi marrë vesh shumë shpejt, vetëm me dy fjalë. Këtij që është aktualisht, po i mungon përvoja. Visar Hasi është shumë i zoti, Jeton Kadiri është shumë aktiv, por ky tjetri, Çanta, nuk e di, në momente të veçanta nuk kemi ujë – në natën e Bajramit. Pra, menaxhim i papërgjegjshëm.

**Mustafë Korenicë:** Faleminderit kryetar! Meqë po bisedojmë për ujin, po ia filloj me këtë pikë: Ne vendin Bërnjak te Hardh-Festi kemi rrjedhje te ujit prej gypit, përafërsisht që 2 muaj. Drejtori i Shërbimeve Publike është këtu, do të ishte mirë të bëni një zgjidhje. Pika e dytë është një vërejtje e vogël për disa prej kompanive, të cilat po kryejnë shërbime apo punë të ndryshme neper objekte, njëra prej tyre tek ndërtesa e Shkollës “Isa Boletini”. Kompania nuk i përdor pajisjet mbrojtëse gjatë punës. Një gjë e tillë rrezikon sigurinë e qytetarëve të asaj zone dhe për qytetarët që ecin afër aty. Në vendin e ashtuquajtur ne bjeshkën

afër Zatriqit, apo në shëtitore ku është investuar nga ana e komunës, qytetaret qe dalin për lëvizje (vikend). Në këtë pjesë të malit, hasim ne rrezik nga qentë endacakë, te cilët janë së bashku me delet e fermave që janë të ndërtuara aty. Gjithashtu, në të njëjtin vend është edhe një pikë ilegale e mbeturinave inerte dhe joine të që ndodhen aty. Do të ishte mirë të eliminohen këtu mbeturina dhe po ashtu, në të njëjtën shëtitore të vendosen shporta për mbeturina.

**Kryetari:** Faleminderit Mustafë! Mbledhja për sot përfundoj. Shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi

Albion Krasniqi

